



LG Electronics Magyar Kft.

H-1097 Budapest, Könyves Kálmán krt. 3/a
T. +36-1-455-60-60 F. +36-1-455-60-66 www.lg.hu

Afatet dhe Kushtet e promociionit "LG 5 vite garanci për frigoriferë dhe makina larëse, 2022 Oferta pranverë"

Kushtet e tanishme të "LG 5 vite garanci" (këtej e tutje referuar si Kushtet) janë të zbatueshme për Konsumatorët të cilët kanë blerë Produkte Frigoriferë ose Makina Larëse, siç përcaktohet në Kushtet, në periudhën 21 Shkurt - 31 Mars, 2022 të tregtuara nga LG Electronics Magyar Kft. në territorin e Shqipërisë dhe të shkarkoni, brenda 60 ditëve pas blerjes, dokumentin 'Çertifikata e 5 viteve garanci për frigoriferë dhe makina larëse, 2022 Oferta pranverë' në www.lgemk-promotions.com/5-year-warranty-ha-alb-2022-02/

Ju, si Konsumator, shprehimisht pranoni që Kushtet e tanishme janë të zbatueshme për fushatën "LG 5-vite garanci për frigoriferë dhe makina larëse, 2022 Oferta pranverë", Ju e pranoni atë si një detyrim për ju, dhe kuptoni se të drejtat në lidhje me të duhet të zbatohen vetëm sipas Kushteve.

1. Bazuar në Kushtet aktuale, dokumenti që verifikon blerjen tuaj (faturë, faturë e thjeshtë, mandat), karta e garancisë së plotësuar dhe dokumenti i shkarkuar 'Çertifikata e 5 viteve garanci për frigorifer dhe makina larëse, 2022 Oferta pranverë', kërkohen të gjitha sëbashku për të aplikuar "LG 5 vite garanci për frigoriferë dhe makina larëse, 2022 Oferta pranverë" për produktin tuaj të blerë gjatë periudhës së fushatës.

2. Çështjet e caktuara të përcaktuara në Kushtet nuk kanë efekt mbi të drejtat tuaja, si konsumator, të zbatueshme në bazë të ligjeve dhe rregullave.

3. "LG 5 vite garanci për frigoriferë dhe makina larëse, 2022 Oferta pranverë" u jep ju të drejtat dhe përparësitë e mëposhtme:

Gjatë 5 (pesë) viteve të llogaritur nga data e blerjes fillestare të Produktit, ekziston një garanci e plotë e shprehur për të gjitha defektet që janë rezultat i gabimit të prodhimit, që do të thotë riparim pa pagesë, pjesë rezervë falas dhe riparim në vend falas (nëse kjo është e nevojshme). Për më tepër, kjo gjithashtu përfshin zëvendësimin falas të Produktit. Nëse Produkti duhet të zëvendësohet gjatë afatit të "LG 5 vite garanci për frigoriferë dhe makina larëse, 2022 Oferta pranverë" (edhe më shumë se një herë), ju do të keni të drejtë të përfitoni kushtet e garancisë ligjore të aplikueshme në momentin e zëvendësimit të Produktit ose afateve dhe kushteve të shprehura të garancisë në bazë të kushteve aktuale të aplikueshme deri në përfundimin e afatit fillestar të "LG 5 vite garanci për frigoriferë dhe makina larëse, 2022 Oferta pranverë" të Produktit që keni blerë, duke përfituar kushtet më të dobishme për Ju, si konsumator.

4. "LG 5 vjet garanci për frigoriferë dhe makina larëse, 2022 Oferta pranverë" është e vlefshme për periudhën 5 vjeçare të llogaritur nga data e blerjes dhe do të zgjatet çdo herë që Produkti do të jetë jashtë funksionit, për shkak të defekteve, me periudhën kohore gjatë të cilit produkti ka qënë jashtë funksionit.

5. Çdo riparim ose zëvendësim do të shënohet në kartën e garancisë të lëshuar nga LGEMK gjatë periudhës 5 vjeçare.

